



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS



**PLANI LOKAL I CILËSISË SË  
AJRIT 2026-2028**



**Përmbajtja**

<b>I. HYRJE</b>	<b>3</b>
1.1 Baza ligjore	3
1.2 Autoritetet kompetente	3
1.3 Efektet shëndetësore të ndotësve të ajrit	4
<b>II. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME</b>	<b>4</b>
2.1 Pozita gjeografike	4
2.2 Popullsia	6
2.3 Kushtet klimatike	7
2.4 Përdorimi i tokës	8
2.5 Trafiku	8
2.6 Ndikimi i hapsirave të gjelbërta në zbutjen e ndotjes së ajrit	10
<b>III. NATYRA DHE VLERËSIMI I NDOTJES SË AJRIT</b>	<b>11</b>
3.1 Stacionet e matjes	11
3.2 Modelet e vlerësimit	11
3.3 Vlerësimi sipas matjeve	11
3.3.1 Grimcat (PM <sub>10</sub> , PM <sub>2.5</sub> )	24
3.3.2 Oksidet e azotit NO <sub>x</sub>	24
3.3.3 Dioksidi i sulfurit SO <sub>2</sub>	25
3.3.4 Ozoni O <sub>3</sub>	25
3.3.5 Monoksidi i karbonit CO	26
<b>IV. ORIGJINA E NDOTËSVE TË AJRIT</b>	<b>26</b>
4.1 Transporti rrugor	26
4.2 Industria	26
4.3 Ngrohja e banesave	27
4.4 Mbetjet	27
<b>V. MASAT E PLANIT TË CILËSISË SË AJRIT DHE MONITORIMI</b>	<b>28</b>

## I. HYRJJE

Cilësia e ajrit përbën një nga komponentët më të rëndësishëm të mjedisit dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e popullsisë, cilësinë e jetesës dhe zhvillimin e qëndrueshëm vendor. Bashkia Patos, për shkak të karakteristikave të saj urbane, pranisë së industrisë së hidrokarbureve dhe intensitetit të trafikut rrugor, paraqet nevojë për një qasje të strukturuar dhe afatgjatë në menaxhimin e cilësisë së ajrit.

Zona e monitorimit të cilësisë së ajrit në Patos klasifikohet si zonë urbane–industriale, për shkak të kombinimit të popullsisë rezidente dhe aktiviteteve industriale. Sipërfaqja e zonës së ndotur përfshin disa kilometra katrorë, ku një pjesë e konsiderueshme e popullsisë është e ekspozuar ndaj ndotësve atmosferikë. Kushtet klimatike, si drejtimi i erërave dhe temperatura mesatare vjetore, ndikojnë në shpërndarjen e ndotjes. Topografia e zonës, kryesisht fushore, favorizon akumulimin e ndotësve gjatë periudhave pa qarkullim ajri. Në këtë zonë identifikohen grupe të ndjeshme si fëmijët, të moshuarit dhe personat me sëmundje respiratore, të cilët kërkojnë mbrojtje të veçantë.

Ky plan synon të analizojë gjendjen aktuale të cilësisë së ajrit, burimet e ndotjes, ndikimet shëndetësore dhe të propozojë masa konkrete për përmirësimin dhe monitorimin e saj.

### 1.1 Baza ligjore

Plani hartohet në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë europian në fushën e mbrojtjes së mjedisit, përfshirë:

- Ligjin nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar
- Ligjin nr. 57, datë 16.10.2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
- Ligjin nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar
- VKM nr. 412, datë 19.06.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”
- VKM nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- VKM nr. 803, datë 04.12.2003 “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”
- Direktivën 2008/50/EC të Bashkimit Europian për cilësinë e ajrit

### 1.2 Autoritetet kompetente

Autoriteti kryesor përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e Planit Lokal të Cilësisë së Ajrit është Bashkia Patos. Bashkia bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Mjedisit për koordinimin e politikave kombëtare mjedisore, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për monitorimin dhe raportimin e të dhënave të cilësisë së ajrit, Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave

për kontrollin e subjekteve industriale si dhe Njësitë e shërbimit Shëndetësor (NJSHP) për ndjekjen e indikatorëve shëndetësore në popullatë.

### 1.3 Efektet shëndetësore të ndotësve të ajrit

Ndotja e ajrit në zonën tonë lidhet kryesisht me praninë e grimcave të pezullta (PM10 dhe PM2.5) dhe gazeve si dioksidi i azotit (NO<sub>2</sub>) dhe dioksidi i squfurit (SO<sub>2</sub>) që vijnë nga proceset industriale dhe trafiku. Ndotësit e ajrit kanë ndikime të drejtpërdrejta dhe afatgjata në shëndetin e popullsisë, veçanërisht tek fëmijët, të moshuarit dhe personat me sëmundje kronike. Efektet përfshijnë:

- Sëmundje të aparatit respirator (astmë, bronkit kronik)
- Probleme kardiovaskulare
- Ulje të imunitetit
- Rritje të rrezikut për sëmundje onkologjike

**Grimcat PM<sub>2.5</sub>:** për shkak të madhësisë së tyre të vogël ato depërtojnë thellë në mushkëri dhe në sistemin e gjakut duke shkaktuar sëmundje kardiovaskulare dhe respiratore kronike.

**NO<sub>2</sub> dhe SO<sub>2</sub>:** Këto gaze janë irritues të fuqishëm të rrugëve ajrore, duke rritur ndjeshëm prekshmërinë ndaj infeksioneve të frymëmarrjes, sidomos tek fëmijët në institucionet arsimore pranë zonave me trafik.

**Ekonomia Qarkulluese:** reduktimi i mbetjeve në burim dhe menaxhimi i mbetjeve industriale luan një rol kyç në uljen e emetimeve sekondare në ajër.

## II. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

### 2.1 Pozita gjeografike

Bashkia Patos ndodhet në qarkun Fier dhe karakterizohet nga zhvillim urban i kombinuar me aktivitet industrial, kryesisht në sektorin e naftës dhe gazit. Bashkia Patos është pjesë e qarkut të Fierit ndodhet 7 km në jugperëndim të qytetit të Fierit, shtrihet përgjatë vargut kodrinor i cili ndan fushën e Myzeqesë nga lugina e lumit Gjanica dhe kufizohet me bashkinë Roskovec, me bashkinë Fier dhe bashkinë Mallakastër me një sipërfaqe prej 82.5 km<sup>2</sup>, ku pika më e lartë arrin në fshatin Drenie 498 m mbi nivelin e detit dhe me shtrirje minimale në fushat e fshatit Sheqishte 11.2 m.

Bashkia ka një pozitë gjeografike të favorshme duke qenë në afërsi të rrugës nacionale Fier-Berat.

Figura 1. Pozita gjeografike




## 2.2 Popullsia

Bashkia Patos përbëhet nga 3 njësi administrative, 1 qytet dhe 18 fshatra. Territori i bashkisë së Patosit shtrihet pjesërisht mbi zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz, e cila përbën një burim natyror të rëndësishëm dhe potencial për zhvillimin ekonomik. Sektorët që ofrojnë punësim për banorët e zonës janë industria e nxjerrjes së naftës, sektori i ndërtimit, bujqësia, blegtoria dhe pemëtaria.

*Tabela 1. Ndarja territoriale e bashkisë Patos*

Qarku Fier (Bashkitë)	Nr. i Bashkive	Bashkia	Njësi Administrative	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Fier Patos Roskovec Lushnje Divjakë Mallakastër	6	Patos	Patos	Qyteti Patos, fshatrat Kuqar, Dukas, Rerës, Margëlliç, Rusinjë, Banaj, Grizë Lënginas
			Zharrëz	Zharrëz, Fshat i Ri, Verbas, Frashër, Sheqishte, Belinë
			Ruzhdie	Ruzhdie, Siqecë, Gjinoqarë Drenie, Kasnicë

*Figura 2. Ndarja territoriale e bashkisë Patos*





### 2.3 Kushtet klimatike

Bashkia Patos bën pjesë në Zonën Mesdhetare kodrinore. Kushtet klimatike ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kuotat e relievit dhe afërsia me detin.

Temperatura mesatare vjetore e ajrit në këtë rajon luhet në kufijtë 15-16°C. Muaji më i ftohtë i vitit është janari me temperaturë mesatare 7.8°C, ndërsa muaji më i nxehtë është korriku me temperaturë mesatare 23.8°C. Fakti që ky rajon karakterizohet nga temperatura të larta, reflektohet edhe në numrin e vogël të ditëve me ngricë (me temperaturë minimale jo më të lartë se 0°C) dhe ditëve me temperaturë minimale.

Regjimi i reshjeve atmosferike në këtë rajon është një regjim tipik mesdhetar. Sasia më e madhe e reshjeve bie në periudhën e ftohtë të vitit ndërsa më pak bien në periudhën e ngrohtë të vitit. Sasia vjetore e reshjeve luhet rreth vlerës 982 mm. Muaji më i lagësht është muaji nëntor në të cilin bien mesatarisht 151 mm, ndërsa muaji më i thatë është muaji korrik në të cilin bien vetëm 21 mm shi.

Sipas të dhënave të publikuara nga Instituti i Hidrometeorologjisë kohëzgjatja e përgjithshme vjetore e rrezatimit diellor në qytetin e Patosit ku ndodhet objekti i ndërtimit është llogaritur 226,32 k-m<sup>2</sup>. Koha me diell përbën mesatarisht 27.792 orë/vit nga të cilat Korrikut i përket numri më i madh dhe Dhjetorit numri më i vogël.

Erërat që ushtrojnë veprimin e tyre në rrethin e Fierit janë: Murlani i cili ndihet në periudhën e dimrit, ka shpejtësi të madhe dhe sjell dy lloje moti si të ftohtë dhe të kthjellët, edhe të ftohtë e me

shira (njihet me emrin Elbasani për shkak të drejtimin sidomos nga veriu dhe verilindja) ; Shiroku quhet ndryshe edhe “Era e deteve”, ndihet në vjeshtë dhe në fund të dimrit, ka drejtimin jug-lindje, është erë e ftohtë dhe e stuhishme dhe sjell ajër të lagët, vranësira dhe reshje; Puhia e cila ndihet kryesisht në verë në formën e një flladi të lehtë, fryn në drejtimin veri-perëndimor (gjatë ditës ka drejtimin nga deti në tokë dhe gjatë natës ka drejtimin nga toka në det). Krijohet për shkak të kontrastit termik që krijohet si rezultat i ngrohjes dhe i ftohjes së ujit dhe tokës; Juga e cila fryn në drejtim të jugut. Në dimër dhe në vjeshtë është e lagët, në pranverë është e ngrohtë dhe e thatë.

#### 2.4 Përdorimi i tokës

Bashkia administron sipërfaqe toke bujqësore të barabartë me 6,054 ha, nga të cilat 3,254 janë tokë bujqësore në fushë dhe 2,800 ha shtrihen në kodra të ulta. Për vetë traditën e qytetit dhe eksperiencën e komunitetit agrobiznesi vazhdon të konsiderohet si një mundësi zhvillimi. Me këtë është e lidhur ngushtë edhe zhvillimi i industrisë së lehtë dhe ushqimore. Toka klasifikohet si në ngjyrë gri në kafe, e ndikuar nga aktiviteti i erozionit dhe me përmbajtje mesatare të humusit dhe azotit.


#### 2.5 Trafiku

Trafiku rrugor është një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit, duke kontribuar kryesisht në emetimin e  $\text{NO}_x$ ,  $\text{PM}_{10}$ ,  $\text{PM}_{2.5}$  dhe CO. Rritja e qarkullimit të automjeteve dhe përdorimi i mjeteve të vjetra përkeqësojnë ndjeshëm cilësinë e ajrit. Në territorin urban të Bashkisë Patos zhvillohet një rrjet rrugor prej rreth 91 km.

Në Bashkinë Patos qarkullojnë në intervalin kohor 06<sup>00</sup>-22<sup>00</sup> rreth 800-1000 automjete në qarkullim dhe 100-200 në qarkullim tranzit si mikrobuza, kamiona dhe motoçikleta.



Figura 4. Kategoria e rrugëve sipas PPV



## 2.6 Ndikimi i hapësirave të gjelbërta në zbutjen e ndotjes së ajrit

Hapësirat e gjelbërta kontribuojnë në:

- Filtrimin e grimcave të imta
- Uljen e temperaturës urbane
- Përmirësimin e mikroklimës
- Përthithjen e CO<sub>2</sub> dhe ndotësve të tjerë

Zgjerimi dhe mirëmbajtja e gjelbërimit publik përbën masë prioritare për Bashkinë Patos.

### III. NATYRA DHE VLERËSIMI I NDOTJES SË AJRIT

Vlerësimi i cilësisë së ajrit kryhet përmes:

- Modeleve matematikore të përhapjes së ndotësve
- Analizës së burimeve ndotëse
- Krahasimit me vlerat kufi ligjore

Në territorin e bashkisë Patos burimi më i madh i ndotësve të ajrit konsiderohet industria e nxjerrjes së naftës, ku proceset e prodhimit lëshojnë në ajër hidrokarbure dhe gazra të dëmshme (si NO<sub>2</sub> dhe të tjera). Këto ndikojnë negativisht në mjedis dhe potencialisht edhe në shëndetin e banorëve. Fusha naftëmbajtëse Patos–Marinëz është e klasifikuar si “zonë e nxehtë ekologjike” dhe shpesh ka mungesë të monitorimit zyrtar të ajrit — *nuk ka stacion monitorimi që të raportojë nivelet e ndotësve si SO<sub>2</sub>, NO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub>, CO, PM<sub>10</sub> etj.* Kjo e bën të vështirë njoftimin e banorëve kur parametra tejkalojnë kufijtë e lejuar ligjorë.

Burimi kryesor zyrtar i të dhënave mjedisore në Shqipëri është Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) nën Ministrinë e Mjedisit. AKM publikon Raportin për Gjendjen e Mjedisit çdo vit, ku trajtohen indikatorët mjedisorë për vendin (p.sh. ndotja e ajrit, ujit, etj.). Këto raporte janë burimi zyrtar më i mirë për gjendjen e ajrit për qytetet ku ka stacione monitorimi. Raportet e viteve të fundit theksojnë se monitorimi i ajrit është i kufizuar në vetëm disa qytete (Tiranë, Korçë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Fier), dhe ende ka vende pa mbulim të plotë.

#### 3.1 Stacionet e matjes

Nisur nga fakti se në territorin e bashkisë nuk ka mbulim zyrtar të monitorimit të ajrit, nga ana e bashkisë kryhen monitorime të përvitshme të cilësisë së parametrave mjedisorë ku përfshihet dhe vlerësimi i cilësisë së ajrit. Monitorimi është kryer kryesisht në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz si dhe në qytet.

#### 3.2 Modelet e vlerësimit

Vlerësimi i cilësisë së ajrit është bërë nga operatorë të certifikuar dhe akredituar nëpërmjet procedurës së prokurimit publik. Vlerësimi i ndotjes së ajrit në Patos bazohet në analizën e përqendrimeve të ndotësve kryesorë gjatë viteve të mëparshme.

#### 3.3 Vlerësimi sipas matjeve

Më poshtë janë rezultatet e monitorimit të cilësisë së ajrit për periudhën 2023-2025.



**RAPORTI I TESTIMIT**  
**PËRCAKTIMI I PËRMBAJTJES SË GRIMCAVE TË NGURTA**  
**AJRI I MJEDISIT**

ASE-011\_FO-02  
 10/01/2021

V-2

Informacioni që përmbahet në këtë dokument është konfidencial i laboratorit ALPHA Studio

FAQE 1 nga 2

Data e Raportimit: 13/06/2023



LT 098

Dt-11.12.2019

RAPORT TESTIMI N<sup>o</sup>: 1505/23Raport i amenduar: Po  Jo 

## INFORMACIONI I KLIENTIT

Emri i Kompanisë/ Klientit: BASHKIA PATOS  
 Titulli i Projektit: Monitorim mjedisor  
 Personi i Kontaktit: Florian Kita  
 Adresa/Vendndodhja: Lagjia Nafetari, Rruga Unaza,  
 Qyteti: FIER  
 Shteti: Shqipëri

## INFORMACIONI I MOSTRËS

Kodi i Identifikimit: 377/05/2023\_Bashkia.Patos  
 Matrica e testimit: Ambient i jashtëm  
 Data e marrjes së mostrës: 30/05/2023  
 Data e pranimit të mostrës në laborator: 30/05/2023  
 Data e kryerjes së testimit: 30/05/2023  
 Mostruesi/Testuesi: ALPHA Studio

## 2. REZULTATE TË TESTIMIT – Pika 1.

Përshkrimi i Stacionit	Parametri	Njësia	Rezultati	Limiti AL (mesatare vjetore)	Limiti AL (mesatare 24h)	
Bashkia Patos	TSP	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	98.7	140	250	
	PM 10	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	34.2	60	150	
	PM2.5	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	9.9	15	66	
<b>Kushtet e Matjes:</b>		<b>Të dhëna të Metodikës së Testimit</b>				
Temp. (°C):	24	Metoda e Testimit:		S SH EN 12341:1998 dhe S SH EN 12341:2014		
Presioni (hPa):	1016	Pasiguria e Metodës së Testimit TSP:		±2.6%		
Lageshtia (%):	51	Pasiguria e Metodës së Testimit PM10:		±2.6%		
Nr.Filtrit TSP	01	Pasiguria e Metodës së Testimit PM2.5:		2.8%		
Nr.Filtrit PM10	02	Instrumenti i Përdorur për Matje:		Micro PNS/LVS 1		
Nr.Filtrit PM2.5	03	Kohëzgjatja e marrjes së mostrës (min):		90 min		
Ora e kryerjes së matjeve:	08:00-09:30	Vëllimi i Ajrit të Mostruar TSP:		1.15 m <sup>3</sup>		
Koordinatat:	40.680788, 19.626627	Vëllimi i Ajrit të Mostruar PM10:		1.15 m <sup>3</sup>		
		Vëllimi i Ajrit të Mostruar PM2.5:		1.15 m <sup>3</sup>		
		Pasiguria e prurjes së ajrit:		5%		
		Devijime nga Metoda:		Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>		

Testoi:  
 Ervis Loce



Laboratori "ALPHA Studio" Sh.p.k. ; Adresa: Rr. Myrteza Topi, Pall.18, Nd 23, 1017, Tiranë, Shqipëri  
 Tel. Cel. 0682097893, e-mail: [studio.alpha19@gmail.com](mailto:studio.alpha19@gmail.com)  
 Shënim: Ky raport testimi i takon vetëm artikujve të testuar. Nuk lejohet kopjimi i pjesës në këtë Raport pa lejen me shkrim të Përgjegjësit të Laboratorit



**RAPORTI I TESTIMIT**  
**PËRCAKTIMI I PËRMBAJTJES SË GRIMCAVE TË NGURTA**  
**AJRI I MJEDISIT**

ASE-011\_FO-02  
10/01/2021

V-2

Informacioni që përmbahet në këtë dokument është konfidencial i laboratorit ALPHA Studio

FAQE 1 nga 2



Data e Raportimit: 13/06/2023

LT 098  
Dt-11.12.2019

**RAPORT TESTIMI N<sup>o</sup>: 1506/23**Raport i amenduar: Po  Jo 

INFORMACIONI I KLIENTIT		INFORMACIONI I MOSTRËS	
Emri i Kompanisë/ Klientit	BASHKIA PATOS	Kodi i Identifikimit:	378/05/2023_Bashkia.Patos
Titulli i Projektit:	Monitorim mjedisor	Matrica e testimit:	Ambient i jashtëm
Personi i Kontaktit:	Florian Kita	Data e marrjes së mostres:	30/05/2023
Adresa/Vendndodhja:	Lagjja Nafetari, Rruga Unaza,	Data e pranimit të mostrës në laborator:	30/05/2023
Qyteti:	FIER	Data e kryerjes së testimit:	30/05/2023
Shteti:	Shqipëri	Mostruesi/Testuesi:	ALPHA Studio

**2. REZULTATE TË TESTIMIT – Pika 2.**

Përshkrimi i Stacionit	Parametri	Njësia	Rezultati	Limiti AL (mesatare vjetore)	Limiti AL (mesatare 24h)
Fshati Zharëz	TSP	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	<b>74.9</b>	140	250
	PM 10	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	<b>26.1</b>	60	150
	PM2.5	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	<b>8.0</b>	15	66

Kushtet e Matjes:		Të dhëna të Metodikës së Testimit	
Temp. (°C):	24	Metoda e Testimit:	S SH EN 12341:1998 dhe S SH EN 12341:2014
Presioni (hPa):	1016	Pasiguria e Metodës së Testimit TSP:	±2.6%
Lageshtia (%):	51	Pasiguria e Metodës së Testimit PM10:	±2.6%
Nr.Filtrit TSP	04	Pasiguria e Metodës së Testimit PM2.5:	2.8%
Nr.Filtrit PM10	05	Instrumenti i Përdorur për Matje:	Micro PNS/LVS 1
Nr.Filtrit PM2.5	06	Kohëzgjatja e marrjes së mostrës (min):	90 min
Ora e kryerjes së matjeve:	10:00-11:30	Vëllimi i Ajrit të Mostruar TSP:	1.15 m <sup>3</sup>
Koordinatat:	40.709740, 19.652358	Vëllimi i Ajrit të Mostruar PM10:	1.15 m <sup>3</sup>
		Vëllimi i Ajrit të Mostruar PM2.5:	1.15 m <sup>3</sup>
		Pasiguria e prurjes së ajrit:	5%
		Devijime nga Metoda:	Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>

Testoi:  
Ervis Loce



Laboratori "ALPHA Studio" Sh.p.k. ; Adresa: Rr. Myrteza Topi, Pall.18, Nd 23, 1017, Tiranë, Shqipëri  
Tel. Cel. 0682097893, e-mail: [studio.alpha19@gmail.com](mailto:studio.alpha19@gmail.com)

Shënim: Ky raport testimi i takon vetëm artikujve të testuar. Nuk lejohet kopjimi i pjesëshëm i këtij Raporti pa lejen me shkrim të Përsjergjës të Laboratorit



**RAPORTI I TESTIMIT**  
**PËRCAKTIMI I PËRMBAJTJES SË GRIMCAVE TË NGURTA**  
**AJRI I MJEDISIT**

ASE-011\_FO-02  
10/01/2021

V-2

Informacioni që përmbahet në këtë dokument është konfidencial i laboratorit ALPHA Studio

FAQE 1 nga 2



Data e Raportimit: 13/06/2023

LT 098  
Dt-11.12.2019

**RAPORT TESTIMI N<sup>o</sup>: 1507/23**Raport i amenduar: Po  Jo 

INFORMACIONI I KLIENITIT		INFORMACIONI I MOSTRËS	
Emri i Kompanisë/ Klientit	BASHKIA PATOS	Kodi i Identifikimit:	379/05/2023_Bashkia.Patos
Titulli i Projektit:	Monitorim mjedisor	Matrica e testimit:	Ambient i jashtëm
Personi i Kontaktit:	Florian Kita	Data e marrjes së mostres:	30/05/2023
Adresa/Vendndodhja:	Lagjia Nafetari, Rruga Unaza,	Data e pranimit të mostrës në laborator:	30/05/2023
Qyteti:	FIER	Data e kryerjes së testimit:	30/05/2023
Shteti:	Shqipëri	Mostruesi/Testuesi:	ALPHA Studio

**2. REZULTATE TË TESTIMIT – Pika 3.**

Përshkrimi i Stacionit	Parametri	Njësia	Rezultati	Limiti AL (mesatare vjetore)	Limiti AL (mesatare 24h)
Fshati Belin	TSP	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	82.6	140	250
	PM 10	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	30.5	60	150
	PM2.5	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	11.4	15	66
<b>Kushtet e Matjes:</b>		<b>Të dhëna të Metodikës së Testimit</b>			
Temp. (°C):	24	Metoda e Testimit:	S SH EN 12341:1998 dhe S SH EN 12341:2014		
Presioni (hPa):	1016	Pasiguria e Metodës së Testimit TSP:	±2.6%		
Lageshtia (%):	51	Pasiguria e Metodës së Testimit PM10:	±2.6%		
Nr.Filtrit TSP	07	Pasiguria e Metodës së Testimit PM2.5:	2.8%		
Nr.Filtrit PM10	08	Instrumenti i Përdorur për Matje:	Micro PNS/LVS 1		
Nr.Filtrit PM2.5	09	Kohëzgjatja e marrjes së mostrës (min):	90 min		
Ora e kryerjes së matjeve:	13:00-14:30	Vëllimi i Ajrit të Mostruar TSP:	1.15 m <sup>3</sup>		
Koordinatat:	40.726750, 19.621852	Vëllimi i Ajrit të Mostruar PM10:	1.15 m <sup>3</sup>		
		Vëllimi i Ajrit të Mostruar PM2.5:	1.15 m <sup>3</sup>		
		Pasiguria e prurjes së ajrit:	5%		
		Devijime nga Metoda:	Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>		

Testoi:  
Ervis Loce

Menaxheri Teknik  
Alma Shehu

Laboratori "ALPHA Studio" Sh.p.k. ; Adresa: Rr. Myrteza Topi, Pall.18, Nd 23, 1017, Tiranë, Shqipëri  
Tel. Cel. 0682097893, e-mail: [studio.alpha19@gmail.com](mailto:studio.alpha19@gmail.com)

Shënim: Ky raport testimi i takon vetëm artikujve të testuar. Nuk lejohet kopjimi i pjesës së këtij Raporti pa lejen me shkrim të Përgjegjës të Laboratorit


**RAPORT TESTIMI - PËRCAKTIMI I PLUHURAVE NË MJEDIS**

 ASE-011\_FO-02  
 19/01/2023/V3

 LT 098  
 Dt.:22.11.2023

Informacioni që përmbahet në këtë dokument është konfidencial i laboratorit ALPHA Studio

**RAPORT TESTIMI N<sup>o</sup>: 3494/24**

 Raport i amenduar: Po  Jo 
**Informacioni i Klientit**

Data e raportimit:	26/08/2024
Emri i Kompanisë/Klientit	BASHKIA PATOS
Personi i kontaktit	Florian Kita
Adresa/Kodi postar i Kompanisë:	Lagjja Naftetari, Rruga Unaza,
Adresa/Vendndodhja e objektit të monitorimit:	Qyteti Patos, pranë bashkisë
Titulli i projektit:	"Shërbim i monitorimit të cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës në zonë naftëmbajtëse Patos-Marinëz".

**Informacioni i mostrës**

Kodi i mostrës:	484/08/2024_Bashkia Patos
Matrica:	Ambient i jashtëm
Përshkrimi i mostrës:	Pika 1- Qendra e qytetit, Patos
Data e marrjes së mostrës:	22/08/2024
Data e pranimit në laborator:	22/08/2024
Data e testimit:	22/08/2024
Marja e mostrës u krye nga:	Alpha Studio
Testimi u krye nga:	Alpha Studio
Deklaratë konformiteti:	Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Baza e deklaratës së konformitetit:	1.Vendim Nr.803, datë 4.12.2003, "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit".

**1. REZULTATE TË TESTIMIT**

PARAMETRI	NJËSIA	REZULTATI	VLERA E REKOMANDUAR
<b>Grimcat totale, TSP</b>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	<b>66.5</b>	250
<b>Grimcat, PM10</b>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	<b>50.6</b>	150
<b>Grimcat PM2.5</b>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	<b>14.7</b>	66
<b>Kushtet e Matjes: Të dhëna të Metodikës së Testimit</b>			
Temp. (°C):	36	Metoda e testimit të pluhurave:	EN 16450:2017
Presioni (hPa):	1011	Metoda e testimit të gazeve:	S SH EN 45544-1:2015 S SH EN 45544-1:2015
Lageshtia (%):	19	Pasiguria e metodës së testimit TSP, PM10:	±1%
Kohëzgjatja e marrjes së mostrës (min):	30	Pasiguria e metodës së testimit të gazeve:	±10%
Ora e kryerjes së matjeve:	13:40-14:10	Instrumenti i përdorur për matjen e pluhurave:	Aerosol mass monitor TEMTOP PMD 351
Koordinatat:	40.680788, 19.626627	Pasiguria e prurjes së ajrit:	2%
		Devijime nga Metoda:	Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>

 Testoi:  
 Ervis Loce.....





**RAPORT TESTIMI - PËRCAKTIMI I PLUHURAVE NË MJEDIS**

 ASE-011\_FO-02  
 19/01/2023/V3

 LT 098  
 Dt.:22.11.2023

Informacioni që përmbahet në këtë dokument është konfidencial i laboratorit ALPHA Studio

**RAPORT TESTIMI N°: 3495/24**

 Raport i amenduar: Po  Jo 
**Informacioni i Klientit**

Data e raportimit:	26/08/2024
Emri i Kompanisë/Klientit	BASHKIA PATOS
Personi i kontaktit	Florian Kita
Adresa/Kodi postar i Kompanisë:	Lagjia Naftetari, Rruga Unaza,
Adresa/Vendndodhja e objektit të monitorimit:	Fshati Zharëz
Titulli i projektit:	"Shërbim i monitorimit të cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës në zonë naftëmbajtëse Patos-Marinëz".

**Informacioni i mostrës**

Kodi i mostrës:	485/08/2024_Bashkia Patos
Matrica:	Ambient i jashtëm
Përshkrimi i mostrës:	Pika 2- Fshati Zharëz
Data e marrjes së mostrës:	22/08/2024
Data e pranimit në laborator:	22/08/2024
Data e testimit:	22/08/2024
Marja e mostrës u krye nga:	Alpha Studio
Testimi u krye nga:	Alpha Studio
Deklaratë konformiteti:	Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Baza e deklaratës së konformitetit:	1.Vendim Nr.803, datë 4.12.2003, "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit".

**1. REZULTATE TË TESTIMIT**

PARAMETRI	NJËSIA	REZULTATI	VLERE E REKOMANDUAR
<b>Grimcat totale, TSP</b>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	<b>81.7</b>	250
<b>Grimcat, PM10</b>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	<b>58.2</b>	150
<b>Grimcat PM2.5</b>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	<b>13.4</b>	66
<b>Kushtet e Matjes: Të dhëna të Metodikës së Testimit</b>			
Temp. (°C):	36	Metoda e testimit të pluhurave:	EN 16450:2017
Presioni (hPa):	1011	Metoda e testimit të gazeve:	S SH EN 45544-1:2015 S SH EN 45544-1:2015
Lageshtia (%):	19	Pasiguria e metodës së testimit TSP, PM10:	±1%
Kohëzgjatja e marrjes së mostrës (min):	30	Pasiguria e metodës së testimit të gazeve:	±10%
Ora e kryerjes së matjeve:	10:20-11:10	Instrumenti i përdorur për matjen e pluhurave:	Aerosol mass monitor TEMTOP PMD 351
Koordinatat:	40.709740, 19.652358	Pasiguria e prurjes së ajrit:	2%
		Devijime nga Metoda:	Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>

 Testoi:  
 Ervis Loce.....





**RAPORT TESTIMI - PËRCAKTIMI I PLUHURAVE NË MJEDIS**

 ASE-011\_FO-02  
 19/01/2023/V3

 LT 098  
 Dt.:22.11.2023

Informacioni që përmbahet në këtë dokument është konfidencial i laboratorit ALPHA Studio

**RAPORT TESTIMI N°: 3496/24**

 Raport i amenduar: Po  Jo 
**Informacioni i Klientit**

Data e raportimit:	26/08/2024
Emri i Kompanisë/Klientit	BASHKIA PATOS
Personi i kontaktit	Florian Kita
Adresa/Kodi postar i Kompanisë:	Lagjia Naftetari, Rruga Unaza,
Adresa/Vendndodhja e objektit të monitorimit:	Fshati Belin
Titulli i projektit:	"Shërbim i monitorimit të cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës në zonë naftëmbajtëse Patos-Marinëz".

**Informacioni i mostrës**

Kodi i mostrës:	486/08/2024_Bashkia Patos
Matrica:	Ambient i jashtëm
Përshkrimi i mostrës:	Pika 3- Fshati Belin
Data e marjes së mostrës:	22/08/2024
Data e pranimit në laborator:	22/08/2024
Data e testimit:	22/08/2024
Marja e mostrës u krye nga:	Alpha Studio
Testimi u krye nga:	Alpha Studio
Deklaratë konformiteti:	Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Baza e deklaratës së konformitetit:	1. Vendim Nr.803, datë 4.12.2003, "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit".

**1. REZULTATE TË TESTIMIT**

PARAMETRI	NJËSIA	REZULTATI	VLERA E REKOMANDUAR
<b>Grimcat totale, TSP</b>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	<b>85.0</b>	250
<b>Grimcat, PM10</b>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	<b>57.3</b>	150
<b>Grimcat PM2.5</b>	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	<b>14.4</b>	66
<b>Kushtet e Matjes: Të dhëna të Metodikës së Testimit</b>			
Temp. ( $^{\circ}\text{C}$ ):	36	Metoda e testimit të pluhurave:	EN 16450:2017
Presioni (hPa):	1011	Metoda e testimit të gazeve:	S SH EN 45544-1:2015 S SH EN 45544-1:2015
Lageshtia (%):	19	Pasiguria e metodës së testimit TSP, PM10:	$\pm 1\%$
Kohëzgjatja e marjes së mostrës (min):	30	Pasiguria e metodës së testimit të gazeve:	$\pm 10\%$
Ora e kryerjes së matjeve:	11:51-12:21	Instrumenti i përdorur për matjen e pluhurave:	Aerosol mass monitor TEMTOP PMD 351
Koordinatat:	40.726750, 19.621852	Pasiguria e prurjes së ajrit:	2%
		Devijime nga Metoda:	Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>

 Testoi:  
 Ervis Loce.....





**RAPORT TESTIMI - PËRCAKTIMI I PLUHURAVE NË MJEDIS**

 ASE-011\_FO-02  
 19/01/2023/IV3

 LT 098  
 Dt.:22.11.2023

Informacioni që përmbahet në këtë dokument është konfidencial i laboratorit ALPHA Studio

**RAPORT TESTIMI N°: 3497/24**

 Raport i amenduar: Po  Jo 
**Informacioni i Klientit**

Data e raportimit:	26/08/2024
Emri i Kompanisë/Klientit	BASHKIA PATOS
Personi i kontaktit	Florian Kita
Adresa/Kodi postar i Kompanisë:	Lagjja Naftetari, Rruga Unaza,
Adresa/Vendndodhja e objektit të monitorimit:	Fshati Sheqishte
Titulli i projektit:	"Shërbim i monitorimit të cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës në zonë naftëmbajtëse Patos-Marinëz".

**Informacioni i mostrës**

Kodi i mostrës:	487/08/2024_Bashkia Patos
Matrica:	Ambient i jashtëm
Përshkrimi i mostrës:	Pika 4- Fshati Sheqishte
Data e marrjes së mostrës:	22/08/2024
Data e pranimit në laborator:	22/08/2024
Data e testimit:	22/08/2024
Marja e mostrës u krye nga:	Alpha Studio
Testimi u krye nga:	Alpha Studio
Deklaratë konformitetit:	Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Baza e deklaratës së konformitetit:	1.Vendim Nr.803, datë 4.12.2003, "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit".

**1. REZULTATE TË TESTIMIT**

PARAMETRI	NJËSIA	REZULTATI	VLERA E REKOMANDUAR
Grimcat totale, TSP	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	102.2	250
Grimcat, PM10	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	58.6	150
Grimcat PM2.5	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	13.2	66
<b>Kushtet e Matjes:</b>	<b>Të dhëna të Metodikës së Testimit</b>		
Temp. ( $^{\circ}\text{C}$ ):	36	Metoda e testimit të pluhurave:	EN 16450:2017
Presioni (hPa):	1011	Metoda e testimit të gazeve:	S SH EN 45544-1:2015 S SH EN 45544-1:2015
Lageshtia (%):	19	Pasiguria e metodës së testimit TSP, PM10:	$\pm 1\%$
Kohëzgjatja e marrjes së mostrës (min):	30	Pasiguria e metodës së testimit të gazeve:	$\pm 10\%$
Ora e kryerjes së matjeve:	12:47-13:20	Instrumenti i përdorur për matjen e pluhurave:	Aerosol mass monitor TEMTOP PMD 351
Koordinatat:	40.72278, 19.62555	Pasiguria e prurjes së ajrit:	2%
		Devijime nga Metoda:	Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>

 Testoi:  
 Ervis Loce.....






## RAPORT TESTIMI - PËRCAKTIMI I GAZEVE NË MJEDIS

ASE-011\_FO-03  
19/01/2023/V3



LT 098  
Dt.:22.11.2023

Informacioni që përmbahet në këtë dokument është konfidencial i laboratorit ALPHA Studio

**RAPORT TESTIMI N°: 3498/24**

Raport i amenduar: Po  Jo

Informacioni i Klientit	
Data e raportimit:	26/08/2024
Emri i Kompanisë/Klientit	BASHKIA PATOS
Personi i kontaktit	Florian Kita
Adresa/Kodi postar i Kompanisë:	Lagjia Naftetari, Rruga Unaza,
Adresa/Vendndodhja e objektit të monitorimit:	Qyteti Patos, pranë bashkisë
Titulli i projektit:	"Shërbim i monitorimit të cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës në zonë naftëmbajtëse Patos-Marinëz".
Informacioni i mostrës	
Kodi i mostrës:	488/08/2024_Bashkia Patos
Matrica:	Ambient i jashtëm
Përshkrimi i mostrës:	Pika 1- Qendra e qytetit, Patos
Data e marrjes së mostrës:	22/08/2024
Data e pranimit në laborator:	22/08/2024
Data e testimit:	22/08/2024
Marja e mostrës u krye nga:	Alpha Studio
Testimi u krye nga:	Alpha Studio
Deklaratë konformiteti:	Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Baza e deklaratës së konformitetit:	1.Vendim Nr.803, datë 4.12.2003, "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit".

### 1. REZULTATE TË TESTIMIT

PARAMETRI	NJËSIA	REZULTATI	VLERA E REKOMANDUAR
Monoksid karboni, CO	mg/m <sup>3</sup>	<1	40
Dioksid azoti, NO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	188.8	250
Dioksid sqfuri, SO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	53.2	360
Ozon, O <sub>3</sub>	µg/m <sup>3</sup>	100.1	230
Komponime organike volatile, VOC	µg/m <sup>3</sup>	<1	5
Kushtet e Matjes:		Të dhëna të Metodikës së Testimit	
Temperatura (°C):	36	Metoda e Testimit:	S SH EN 45544-1:2015 S SH EN 45544-1:2015
Presioni (kPa):	1011	Instrumenti i Përdorur për Matje:	Honeywell mini RAE PLUS, MSA ALTAIR 5X, AEROQUAL SERIE 200, TESTO 435
Lagështia (%):	19	Kufiri i diktimit të CO	1 ppm / 1.14 mg/m <sup>3</sup>
Kohëzgjatja e testimit (min):	15 min	Kufiri i diktimit të NO <sub>2</sub>	0.001 ppm/1.88 µg/m <sup>3</sup>
Ora e kryerjes së matjeve:	13:40-13:55	Kufiri i diktimit të SO <sub>2</sub>	0.01 ppm/26 µg/m <sup>3</sup>
Koordinatat:	40.680788,	Kufiri i diktimit të O <sub>3</sub>	0.001 ppm/1.9 µg/m <sup>3</sup>
	19.626627	Kufiri i diktimit të VOC	0.001 ppm/3.2 µg/m <sup>3</sup>
		Devijime nga Metoda:	Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>

Testoi:  
Ervis Loce.....




**RAPORT TESTIMI - PËRCAKTIMI I GAZEVE NË MJEDIS**

 ASE-011\_FO-03  
 19/01/2023/V3

 LT 098  
 Dt.:22.11.2023

Informacioni që përmbahet në këtë dokument është konfidencial i laboratorit ALPHA Studio

**RAPORT TESTIMI N°: 3499/24**

 Raport i amenduar: Po  Jo 
**Informacioni i Klientit**

Data e raportimit:	26/08/2024
Emri i Kompanisë/Klientit	BASHKIA PATOS
Personi i kontaktit	Florian Kita
Adresa/Kodi postar i Kompanisë:	Lagjja Naftetari, Rruga Unaza,
Adresa/Vendndodhja e objektit të monitorimit:	Fshati Zharëz
Titulli i projektit:	"Shërbim i monitorimit të cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz".

**Informacioni i mostrës**

Kodi i mostrës:	489/08/2024_Bashkia Patos
Matrica:	Ambient i jashtëm
Përshkrimi i mostrës:	Pika 2- Qendra e Fshatit Zharëz
Data e marrjes së mostrës:	22/08/2024
Data e pranimit në laborator:	22/08/2024
Data e testimit:	22/08/2024
Marja e mostrës u krye nga:	Alpha Studio
Testimi u krye nga:	Alpha Studio
Deklaratë konformiteti:	Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Baza e deklaratës së konformitetit:	1.Vendim Nr.803, datë 4.12.2003, "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit".

**1. REZULTATE TË TESTIMIT**

PARAMETRI	NJËSIA	REZULTATI	VLERA E REKOMANDUAR
Monoksid karboni, CO	mg/m <sup>3</sup>	1.15	40
Dioksid azoti, NO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	235	250
Dioksid squfuri, SO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	314	360
Ozon, O <sub>3</sub>	µg/m <sup>3</sup>	<2	230
Komponime organike volatile, VOC	µg/m <sup>3</sup>	<1	5
<b>Kushtet e Matjes:</b>			
<b>Të dhëna të Metodikës së Testimit</b>			
Temperatura (°C):	36	Metoda e Testimit:	S SH EN 45544-1:2015 S SH EN 45544-1:2015
Presioni (kPa):	1011	Instrumenti i Përdorur për Matje:	Honeywell mini RAE PLUS, MSA ALTAIR 5X, AEROQUAL SERIE 200, TESTO 435
Lagështia (%):	19	Kufiri i diktimit të CO	1 ppm / 1.14 mg/m <sup>3</sup>
Kohëzgjatja e testimit (min):	15 min	Kufiri i diktimit të NO <sub>2</sub>	0.001 ppm/1.88 µg/m <sup>3</sup>
Ora e kryerjes së matjeve:	11:00-11:15	Kufiri i diktimit të SO <sub>2</sub>	0.01 ppm/26 µg/m <sup>3</sup>
Koordinatat:	40.709740,	Kufiri i diktimit të O <sub>3</sub>	0.001 ppm/1.9 µg/m <sup>3</sup>
	19.652358	Kufiri i diktimit të VOC	1 µg/m <sup>3</sup>
		Devijime nga Metoda:	Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>

 Testoi:  
 Ervis Loce






## RAPORT TESTIMI - PËRCAKTIMI I GAZEVE NË MJEDIS

ASE-011\_FO-03  
19/01/2023/V3



LT 098  
Dt.: 22.11.2023

Informacioni që përmbahet në këtë dokument është konfidencial i laboratorit ALPHA Studio

### RAPORT TESTIMI N<sup>o</sup>: 3500/24

Raport i amenduar: Po  Jo

Informacioni i Klientit	
Data e raportimit:	26/08/2024
Emri i Kompanisë/Klientit	BASHKIA PATOS
Personi i kontaktit	Florian Kita
Adresa/Kodi postar i Kompanisë:	Lagjja Naftetari, Rruga Unaza,
Adresa/Vendndodhja e objektit të monitorimit:	Fshati Belin
Titulli i projektit:	"Shërbim i monitorimit të cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz".
Informacioni i mostrës	
Kodi i mostrës:	490/08/2024_Bashkia Patos
Matrica:	Ambient i jashtëm
Përshkrimi i mostrës:	Pika 3- Qendra e Fshatit Belin
Data e marrjes së mostrës:	22/08/2024
Data e pranimit në laborator:	22/08/2024
Data e testimit:	22/08/2024
Marja e mostrës u krye nga:	Alpha Studio
Testimi u krye nga:	Alpha Studio
Deklaratë konformiteti:	Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Baza e deklaratës së konformitetit:	1.Vendim Nr.803, datë 4.12.2003, "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit".

### 1. REZULTATE TË TESTIMIT

PARAMETRI	NJËSIA	REZULTATI	VLERA E REKOMANDUAR
Monoksid karboni, CO	mg/m <sup>3</sup>	<1	40
Dioksid azoti, NO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	30.1	250
Dioksid sqfuri, SO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	53.2	360
Ozon, O <sub>3</sub>	µg/m <sup>3</sup>	<2	230
Komponime organike volatile, VOC	µg/m <sup>3</sup>	<1	5
Kushtet e Matjes:		Të dhëna të Metodikës së Testimit	
Temperatura (°C):	36	Metoda e Testimit:	S SH EN 45544-1:2015 S SH EN 45544-1:2015
Presioni (kPa):	1011	Instrumenti i Përdorur për Matje:	Honeywell mini RAE PLUS, MSA ALTAIR 5X, AEROQUAL SERIE 200, TESTO 435
Lagështia (%):	19	Kufiri i diktimit të CO	1 ppm / 1.14 mg/m <sup>3</sup>
Kohëzgjatja e testimit (min):	15 min	Kufiri i diktimit të NO <sub>2</sub>	0.001 ppm/1.88 µg/m <sup>3</sup>
Ora e kryerjes së matjeve:	11:55-12:10	Kufiri i diktimit të SO <sub>2</sub>	0.01 ppm/26 µg/m <sup>3</sup>
Koordinatat:	40.726750,	Kufiri i diktimit të O <sub>3</sub>	0.001 ppm/1.9 µg/m <sup>3</sup>
	19.621852	Kufiri i diktimit të VOC	1 µg/m <sup>3</sup>
		Devijime nga Metoda:	Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>

Testoi:  
Ervis Loce.....





## RAPORT TESTIMI - PËRCAKTIMI I GAZEVE NË MJEDIS

ASE-011\_FO-03  
19/01/2023/V3



LT 098  
Dt.:22.11.2023

Informacioni që përmbahet në këtë dokument është konfidencial i laboratorit ALPHA Studio

**RAPORT TESTIMI N°: 3501/24**

Raport i amenduar: Po  Jo

### Informacioni i Klientit

Data e raportimit:	26/08/2024
Emri i Kompanisë/Klientit	BASHKIA PATOS
Personi i kontaktit	Florian Kita
Adresa/Kodi postar i Kompanisë:	Lagjja Naftetari, Rruga Unaza,
Adresa/Vendndodhja e objektit të monitorimit:	Fshati Sheqishte
Titulli i projektit:	"Shërbim i monitorimit të cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz".

### Informacioni i mostrës

Kodi i mostrës:	491/08/2024_Bashkia Patos
Matrica:	Ambient i jashtëm
Përshkrimi i mostrës:	Pika 4- Qendra e Fshatit Sheqishte
Data e marrjes së mostrës:	22/08/2024
Data e pranimit në laborator:	22/08/2024
Data e testimit:	22/08/2024
Marja e mostrës u krye nga:	Alpha Studio
Testimi u krye nga:	Alpha Studio
Deklaratë konformiteti:	Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Baza e deklaratës së konformitetit:	1.Vendim Nr.803, datë 4.12.2003, "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit".

### 1. REZULTATE TË TESTIMIT

PARAMETRI	NJËSIA	REZULTATI	VLERA E REKOMANDUAR
Monoksid karboni, CO	mg/m <sup>3</sup>	<1	40
Dioksid azoti, NO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	10.2	250
Dioksid sqfuri, SO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	<26	360
Ozon, O <sub>3</sub>	µg/m <sup>3</sup>	39.2	230
Komponime organike volatile, VOC	µg/m <sup>3</sup>	<1	5 *
<b>Kushtet e Matjes:</b>			
<b>Të dhëna të Metodikës së Testimit</b>			
Temperatura (°C):	36	Metoda e Testimit:	S SH EN 45544-1:2015 S SH EN 45544-1:2015
Presioni (kPa):	1011	Instrumenti i Përdorur për Matje:	Honeywell mini RAE PLUS, MSA ALTAIR 5X, AEROQUAL SERIE 200, TESTO 435
Lagështia (%):	19	Kufiri i diktimit të CO	1 ppm / 1.14 mg/m <sup>3</sup>
Kohëzgjatja e testimit (min):	15 min	Kufiri i diktimit të NO <sub>2</sub>	0.001 ppm/1.88 µg/m <sup>3</sup>
Ora e kryerjes së matjeve:	13:00-13:15	Kufiri i diktimit të SO <sub>2</sub>	0.01 ppm/26 µg/m <sup>3</sup>
Koordinatat:	40.72278, 19.62555	Kufiri i diktimit të O <sub>3</sub>	0.001 ppm/1.9 µg/m <sup>3</sup>
		Kufiri i diktimit të VOC	1 µg/m <sup>3</sup>
		Devijime nga Metoda:	Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>

Testoi:  
Ervis Loce.....



 <b>Eko Studio Projekt</b> <b>FO - 15</b>	<b>Flete - Analize</b> <b>EKO - STUDIO - PROJEKT</b>	Data e Miratimit 11/02/2022	 <b>DA</b> LT 070 11.02.22 Rishikimi: 8 Page 4 103614803Q
		Rishikimi: 8	

### 5. RAPORT TESTIMI 1 – MONITORIMI I NDOTJES SE AJERIT

 <b>EKO STUDIO PROJEKT</b>	
<b>NIPT-i L03614803Q - Licencë Profesionale QKL LN-2652-01-2011</b> Bulevardi Gjegj Fishta, Nr. 48, Tiranë, Albania.	
<b>Raport - Testimi</b>	<b>Nr. 852</b>
Data e marrjes se kampionit Nr <b>852</b> Prot	Data e analizimit te kampionit <b>31/07/2025</b>
Data <b>21/08/2025</b>	
Subjekti i Monitoruar	<b>Bashkia Patos</b>
Adresa e Subjektit	<b>Lagjja "Nafiçtari", Rruga "Unaza"</b>
Vendodhja e matjes	Ne mjediset e laboratorit <input type="checkbox"/> Jashte mjediseve te Laboratorit <input checked="" type="checkbox"/>
Tipi i matjes	Lloji i kampionit: <b>Gaz</b> Tipi i kampionit: <b>Ambient</b>
Plani i kampionimit	<b>BS EN ISO 12341:2014</b>

Nr.	Komponentë te matur	Metoda	Të dhënat e matjes				Njesia
			Pika I	Pika II	Pika III	Pika IV	
1.	PM 10	SSH EN 12341:2014	28	20	17	59	µg/m <sup>3</sup>
2.	PM 2.5	SSH EN 12341:2014	9	8	42	10	µg/m <sup>3</sup>
3.	CO	SSH EN 45544-1/2:2015 SSH EN 50271	0.0	0.0	0.0	0.0	ppm
4.	O <sub>2</sub>	ISO 50104:2002 EN 45544 -1:2015	20.7	20.6	20.9	21	%
5.	C <sub>6</sub> H <sub>6</sub> *	ISO 14662-2:2005	0	0	0	0	ppm
6.	O <sub>3</sub> *	ISO 13964:2005	<0.05	<0.05	<0.05	<0.05	ppm
7.	NO <sub>x</sub>	SSH EN 14792:2017 SSH EN 50379-1/2:2012	0	0	0	0	ppm
8.	SO <sub>2</sub>	SSH EN 14791:2017 SSH EN 50379-1/2:2012	0	0	1	0	ppm
9.	Temperatura ne ajer	SSH EN ISO 7730:2005	34.2	33.5	33.0	36.7	°C
10.	Lageshtia	ISO 9662:1994	47.5	51.1	49.4	49.5	%

Analizat u kryen nga:

Aprovuar nga:

Ing:

Shëfqi i Laboratorit

Ky raport testimi i perket kampionit te marre ose sjelle nga klienti i kontraktuar, nuk lejohet e drejta e riprodheshmerise se tij pa dijenine e laboratorit testues te Eko-Studio-Projekt. Çdo reklamim i tij behet me shkrim ne nje peritidhe jo me shume se 5 dite nga data e dorezimit te ketij raporti testimi duke marre parasysh kushtet ambientale ne te cilat eshte kryer testimi (lageshti, presion,temp etj.)

Pikat ku u kryen matjet dhe kampionimet.

	Pershkrimi	Shenim
Pika I-	X:468029.04 Y:4510639.48	Zone rurale nen ndikimin e shkarkimeve industriale
Pika II-	X:469780.93 Y:45122049.47	Zone rurale nen ndikimin e shkarkimeve industriale
Pika III-	X:468152.21 Y:4505303.57	Zone rurale nen ndikimin e shkarkimeve industriale
Pika IV-	X: 470571.78 Y: 4507471.48	Zona urbane jashte ndikimit industrial

\*\*Parafundimet e paraqitura me \* nuk jane pjese e fushes se akreditimit

Ky Raport-Testimi nuk lejohet te riprodhohet i plote ose i pjesshem pa dijenine e laboratorit testues, Eko-Studio-Projekt.  
Çdo reklamim i tij behet me shkrim ne ne nje peritidhe jo me shume se 5 dite nga data e dorezimit te Tije.

e-Mail: [eko\\_studio@yahoo.com](mailto:eko_studio@yahoo.com)[eko.projekt@yahoo.com](mailto:eko.projekt@yahoo.com)

Tel. Cel. 00355 69 20 77227

Nisur dhe nga rezultatet e monitorimeve përgjatë periudhës 2023-2025, rezultatet e testeve janë brenda normave të përcaktuara në VKM nr. 803, datë 04.12.2003 “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”. Vlerat e standardit janë për matje mesatare 1-orëshe. Për një monitorim sa më efektiv të parametrevë të cilësisë së ajrit duhet të kryhen monitorime 24-orëshe.

### 3.3.1 Grimcat (PM<sub>10</sub>, PM<sub>2.5</sub>)

PM<sub>10</sub> janë grimca të ngurta ose të lëngshme të pezulluara në ajër me diametër aerodinamik deri në 10 mikrometra. Sipas legjislacionit mjedisor, këto grimca konsiderohen ndotës të rrezikshëm për shëndetin e njeriut, pasi mund të depërtojnë në traktin respirator të sipërm. Direktiva 2008/50/EC i klasifikon PM<sub>10</sub> si një nga ndotësit kryesorë, për të cilët duhet monitorim i vazhdueshëm dhe kufij maksimalë të përqendrimit. Ekspozimi afatgjatë ndaj PM<sub>10</sub> lidhet me sëmundje respiratore, kardiovaskulare dhe rritje të vdekshmërisë. PM<sub>10</sub> ndikon gjithashtu në uljen e dukshmërisë dhe degradimin e ekosistemeve.

#### *Burimet kryesore të ndotjes nga grimcat PM<sub>10</sub>:*

- Trafiku rrugor (fërkimi i gomave dhe frenave)
- Pluhuri nga ndërtimet dhe guroret
- Proceset industriale
- Djegia e lëndëve djegëse fosile
- Resuspensionimi i pluhurit nga toka

PM<sub>2.5</sub> janë grimca shumë të imëta të cilat mund të depërtojnë thellë në mushkëri dhe madje të kalojnë në qarkullimin e gjakut. Legjislacioni evropian i konsideron PM<sub>2.5</sub> veçanërisht të rrezikshme për shëndetin publik për shkak të madhësisë së tyre të vogël. Direktiva 2008/50/EC përcakton objektiva afatgjata për reduktimin e ekspozimit ndaj PM<sub>2.5</sub> në zonat urbane. Këto grimca janë të lidhura ngushtë me sëmundje kronike, astmë, goditje në tru dhe kancer të mushkërive. PM<sub>2.5</sub> kanë edhe ndikim në ndryshimet klimatike duke ndikuar në balancën e rrezatimit.

#### *Burimet kryesore të ndotjes:*

- Djegia e drurit dhe qymyrit për ngrohje
- Automjetet me naftë
- Termocentralet
- Proceset industriale
- Formimi sekondar nga gazra ndotës (NO<sub>x</sub>, SO<sub>2</sub>)

### 3.3.2 Oksidet e azotit NO<sub>x</sub>

NO<sub>x</sub> përfaqëson një grup gazrash ndotës që përfshijnë monoksidin e azotit (NO) dhe dioksidin e azotit (NO<sub>2</sub>). Sipas legjislacionit mjedisor, NO<sub>2</sub> është komponenti më i rrezikshëm për shëndetin e njeriut. Direktiva 2008/50/EC përcakton kufij të rreptë për përqendrimin e NO<sub>2</sub> në ajrin

ambiental.  $\text{NO}_x$  kontribuon në formimin e ozonit troposferik dhe grimcave sekondare  $\text{PM}_{2.5}$ . Ekspozimi ndaj  $\text{NO}_2$  shkakton irrim të rrugëve të frymëmarrjes dhe përkeqësim të sëmundjeve pulmonare.

***Burimet kryesore të ndotjes:***

- Trafiku rrugor
- Termocentralet
- Djegia e karburanteve fosile
- Proceset industriale

**3.3.3 Dioksidi i sulfurit  $\text{SO}_2$**

$\text{SO}_2$  është një gaz pa ngjyrë me erë të fortë dhe irrituese. Legjislacioni evropian e klasifikon  $\text{SO}_2$  si ndotës acidifikues me ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin dhe mjedisin. Direktiva 2008/50/EC përcakton vlera kufi për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të ekosistemeve.  $\text{SO}_2$  kontribuon në formimin e shiut acid dhe grimcave të imëta sulfatike. Ekspozimi i shkurtër ndaj niveleve të larta të  $\text{SO}_2$  mund të shkaktojë bronkospazma dhe vështirësi në frymëmarrje.

***Burimet kryesore të ndotjes:***

- Djegia e qymyrit dhe naftës
- Termocentralet
- Rafineritë
- Industria metalurgjike

**3.3.4 Ozoni  $\text{O}_3$**

Ozoni në shtresën e ulët të atmosferës është një ndotës sekondar, i formuar nga reaksionet fotokimike të  $\text{NO}_x$  dhe përbërjeve organike të paqëndrueshme. Legjislacioni mjedisor e dallon qartë ozonin troposferik nga ai stratosferik, i cili është mbrojtës. Direktiva 2008/50/EC përcakton objektiva për mbrojtjen e shëndetit dhe vegetacionit nga ozoni.  $\text{O}_3$  shkakton irrim të syve, mushkërive dhe ulje të funksionit respirator. Ai ndikon negativisht edhe në prodhimtarinë bujqësore dhe biodiversitet.

***Burimet kryesore të ndotjes (indirekte):***

- Trafiku rrugor
- Industria
- Avullimi i karburanteve
- Reaksione fotokimike në prani të rrezatimit diellor

### 3.3.5 Monoksidi i karbonit CO

CO është një gaz pa ngjyrë, pa erë dhe shumë toksik. Legjislacioni evropian e konsideron CO si ndotës të rrezikshëm për shkak të aftësisë së tij për t'u lidhur me hemoglobinën në gjak. Direktiva 2008/50/EC vendos kufij maksimalë për ekspozimin ditor ndaj CO. Ky gaz pengon transportin e oksigjenit në trup dhe mund të shkaktojë marramendje, humbje ndjenje dhe vdekje. CO ka ndikim kryesisht në zonat urbane me trafik të dendur.

#### Burimet kryesore të ndotjes:

- Automjetet me djegie të brendshme
- Djegia jo e plotë e karburanteve
- Ngrohja shtëpiake
- Industria
- Gjeneratorët dhe pajisjet me benzinë

## IV. ORIGJINA E NDOTËSVE TË AJRIT

Burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Bashkinë Patos lidhen me aktivitetet industriale të sektorit të naftës. Shkarkimet nga proceset teknologjike dhe djegia e karburanteve përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të emetimeve. Transporti rrugor, përfshirë automjetet e vjetra, kontribuon gjithashtu në ndotjen e ajrit. Sasia totale e shkarkimeve vlerësohet në bazë vjetore dhe shprehet në ton për vit. Një pjesë e ndotjes vjen edhe nga rajone përreth, përmes transportit të ndotësve në atmosferë.

### 4.1 Transporti rrugor

Ngjashëm me qytetet e mëdha urbane, ndonëse në përmasa më të vogla, transporti rrugor në Patos përbën një burim të rëndësishëm të ndotjes. Shumica e automjeteve që qarkullojnë përdorin naftë si lëndë djegëse dhe janë të prodhimit të vjetër, shpesh pa teknologji për filtrimin e emetimeve të dëmshme.

### 4.2 Industria

Zona e Patosit ka një histori të gjatë me nxjerrjen e hidrokarbureve, e cila ka kontribuar ndjeshëm në ndotjen e mjedisit:

- Përdorimi i pusetave të mbetjeve dhe rrjedhjet e papërpunuara të naftës kanë ndikuar në ndotjen e tokës dhe ajrit.
- Ndotës si **oksidet e sulfurit (SO<sub>2</sub>)**, **metalet e rënda**, **hidrokarburet aromatike** janë zbuluar në nivele të larta në tokë dhe ujë në zonën përreth (sipas një raporti nga Monitor.al, 2022).

### 4.3 Ngrohja e banesave

Ngrohja e banesave ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e ajrit, sidomos gjatë muajve të dimrit. Shumë familje përdorin dru zjarri, qymyr ose karburante të tjera fosile, të cilat çlirojnë grimca të imta dhe gazra ndotës. Këto emetime rrisin përqendrimin e  $PM_{2.5}$  dhe  $PM_{10}$  në ajër, duke e bërë frymëmarrjen më të vështirë. Kushtet meteorologjike dimërore, si mungesa e erës, e përkeqësojnë grumbullimin e ndotjes. Në zona urbane sobat individuale krijojnë burime të shumta ndotjeje të shpërndara. Ndotja e ajrit nga ngrohja rrit rrezikun për probleme respiratore dhe kardiovaskulare te banorët. Fëmijët dhe të moshuarit janë grupet më të ndjeshme ndaj këtyre ndotësve. Përdorimi i pajisjeve të vjetra dhe djegia joefikase e karburanteve e shtojnë ndotjen. Kalimi drejt ngrohjes më të pastër do të ulte ndjeshëm emetimet. Masat informuese dhe mbështetja për eficiencën energjetike mund të përmirësojnë cilësinë e ajrit në Patos.

### 4.4 Mbetjet

Ndarja e mbetjeve në burimëshhtë një proces kyç që ndikon drejtpërdrejtë në pastërtinë e ajrit që thithim. Ndarja e mbetjeve redukton emetimet e dëmshme në disa nivele:

1.Reduktimi i gazeve serë: Kur mbetjet organike (mbetjet ushqimore) nuk ndahen në burim dhe përfundojnë në venddepozitime (landfille) të përziera me plastikë, letra ato dekompozohen në mënyrë anaerobe (pa oksigjen). Ky proces prodhon metan  $CH_4$  një gaz që është deri në 25 herë më i fuqishëm se  $CO_2$  në ngrohjen globale. Ndarja në burim lejon kompostimin e mbetjeve duke minimizuar prodhimin e metanit dhe duke mbajtur ajrin më të pastër.

2.Eleminimi i djegies së mbetjeve në terren: Duke i ndarë mbetjet e riciklueshme (plastikë, letër, metal) ulet rrezikun e djegies aksidentale apo të qëllimshme duke parandaluar këta ndotës kancerogjene që të futen në atmosferën tonë.


3.Ulja e emetimeve nga transporti dhe industria: Ndarja e mbetjeve ndikon në cilësinë e ajrit pasi transporti i ndarë i mbetjeve është më efikas. Reduktimi i vëllimit të mbetjeve që shkojnë në landfill do të thotë më pak rrugë për mjetet e grumbullimit, që përkthehet në më pak emetime të  $NO_2$  dhe  $PM_{10}$  nga djegia e naftës. Përpunimi i lëndës së parë të ricikluar (alumin apo plastikë) kërkon shumë më pak energji sesa prodhimi nga lënda e parë. Më pak energji e konsumuar do të thotë më pak emetime nga centralët energjetike.

4.Parandalimi i grimcave të pezullta (PM): Mbetjet e përziera që lihen në ambiente të hapura gjatë procesit të dekompozimit mund të çlirojnë grimca të imta dhe aromë të keqe, të cilat përbëjnë shqetësim për sistemin respirator të banorëve. Ndarja në burim siguron një menaxhim më të shpejtë dhe më higjienik duke mbajtur pezullinë e grimcave në nivele minimale.

Ky proces është themeli i ekonomisë qarkulluese ku çdo mbetje e ndarë është një burim më pak që ndot ajrin tonë dhe një lëndë e parë më shumë për industrinë e gjelbër.

## V. MASAT E PLANIT TË CILËSISË SË AJRIT DHE MONITORIMI

Masat e propozuara në kuadër të planit synojnë uljen e ndotjes pas miratimit të këtij plani. Për secilën masë është përgatitur një përshkrim i detajuar dhe një grafik zbatimi. Masat përfshijnë kontrollin e emetimeve industriale, përmirësimin e transportit dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik.



Nr.	Masa	Afati Kohor	Tregues/Matës	Monitorimi	Shënime
1.	Zgjerimi i hapësirave të gjelbra urbane. Mbjellje pemësh dhe krijim parqesh në zona të ndotura.	2026-2028	Sipërfaqja e shtuar me gjelbërim	Bashkia	Vegjetacioni absorbon grimcat dhe përmirëson mikroklimën.
2.	Monitorim dhe raportim i përmirësimeve të ajrit. Rritja e numrit të monitorimeve të cilësisë së ajrit në zonat potencialisht të ndotura.	Çdo vit	Numri i monitorimeve	Bashkia AKM	Siguron transparencë dhe bazë për rregullime politike dhe investime të ardhshme.
3.	Nxitje e transportit alternativ dhe ulja e trafikut. Promovimi i ecjes, përdorimit të biçikletave dhe transportit publik.	2026-2028	Numri i aktiviteteve	Bashkia	Reduktimi i emetimeve nga trafiku përmirëson ajrin urban.
4.	Fushata informuese për energjinë efikase dhe cilësinë e ajrit. Edukim për qytetarët rreth mënyrave të ngrohjes më të pastra, izolimit të shtëpive dhe mirëmbajtjes së pajisjeve.	2026-2028	Fletëpalosje të shpërndara.	Bashkia	Rrit ndërgjegjësimin dhe sjellje më të mira për ngrohje dhe kursim energjie.
5.	Reduktimi i përdorimit të karburanteve fosil dhe drurit për ngrohje në ndërtesa publike (institucione arsimore).	Brenda vitit 2028	Numri ose përqindja e ndërtesave që kalojnë në karburante më të pastra ose izolim termik.	Bashkia	Ulje e përqendrimit të PM <sub>2.5</sub> dhe PM <sub>10</sub> në ajër.
6.	Projekte pilot për ndarjen e mbetjeve në burim	2026-2028	Reduktimi i sasisë së mbetjeve që depozitohen në pikën fundore të trajtimit të mbetjeve.	Bashkia	Reduktim i gazeve me efekt serë